



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.89, datë 27.07.2020

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 80, DATË 26.07.2017 TË KËSHILLIT BASHKIAK TIRANË “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR RISHIKIMIN E EMËRTIMEVE TË PJESËVE TË TERRITORIT PUBLIK (BULEVARD, RRUGË, RRUGICË SHESH, PARK) DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 3 shkronja “ç”, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1 shkronjat “b” dhe “d”, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar; nenit 5, shkronja “ç” të ligjit 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, vendimit nr.157 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, i ndryshuar; si dhe memo me nr. Prot. 19648, datë 17.06.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Promovimit të Qytetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 80, datë 26.07.2017 i Këshillit Bashkiak Tiranë “Për krijimin e komisionit këshillimor për rishikimin e emërtimeve të pjesëve të territorit publik (bulevard, rrugë, rrugicë shesh, park) dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**1.** Pika 2, ndryshohet si vijon:

“Komisioni vepron si organ Këshillimor pranë Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe përbëhet nga 5 anëtar, si më poshtë:

- a. Prof. Nevila Nika
- b. Prof. Fatmira Rama
- c. Prof. Ylljet Aliçka
- d. Prof. Pëllumb Xhufi
- e. Prof. Marenglen Kasmi

**2.** Pika 3, ndryshohet si vijon:

“Komisioni Këshillimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij për një afat kohor 1 vjeçar (Korrik 2020- Korrik 2021). Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të komisionit, Këshilli Bashkiak mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit”.

**3.** Efektet financiare të pikës 2 të këtij vendimi do të përballohen nga aparati i Bashkisë, në programin e administratës vendore, artikulli 602 të parashikuara në buxhetin e vitit 2020.

4. Ngarkohen Komisioni Këshillimor, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për krijimin e kushteve të punës, mbështetjen financiare e logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**